



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

*01. Nr. 464-20356/17
Kaçanik, 30.06.2017*

Në bazë të nenit 12, 14, 17 lidhur me nenin 18.1(a) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2.4 dhe nën paragrafi 3.3.10 të Ligjit 03/L-139 -Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit 03/L-139 -Për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 91), të nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me. 30 Qershor 2017, mori këtë :

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PARCELËN KADASTRALE NR. 00911-1, NË Z.K. SOPONICË, PËR NDËRTIMIN E REZERVUARIT TË UJIT TË PIJES, PËR FSHATRAT: ELEZAJ, DOGANAJ, KOXHAJ DHE KAÇANIK I VJETËR

1. Me këtë Vendim, Shpallet me interes të përgjithshëm publik –për interesa të Komunës së Kaçanikut, patundshmëria Nr.00911-1 në Zonën Kadastrale në Soponicë, me kulturë Mal i Klasës së 3 (Tretë), në sipërfaqe; 0.13,89 ha, sipas Certifikatës Njësia Kadastrale Nr.70917083--00911-1, në emër të Fahri(Nazmi) Demnika, me Nr. të Lëndës: 303/2017, të datës 28.06.2017.
2. Parcela Kadastrale si në pikën I të këtij Vendimi, është e paraparë të destinohet për interesin e Komunës Kaçanik, për Ndërtimin e Rezervuarit të Ujit të Pijes, për fshatrat: Elezaj, Doganaj, Koxhaj dhe Kaçanik i Vjetër.
3. Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit të Pijes është në interesit të përgjithshëm publik për interesa të komunës së Kaçanikut- për 4 fshatra të komunës së Kaçanikut dhe lidhur me parcelën me numër të sipërsënuar si në pikën I, të këtij Vendimi, mund të fillojë procedura e Shpronësimit, dhe në asnjë mënyrë kjo pronë nuk mund të tjetërsohen dhe as t'i ndërrohet destinimi, pa Vendimin e Kuvendit të Komunës Kaçanik.

4. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas dispozitave ligjore të ligjeve në fuqi, t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i komunës, drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Certifikata me Nr. të Njesisë Kadastrale Nr. P-70917083-00911-1, Kopja e Planit si dhe Aktvendimi e DUKMM me Nr. 303/2017, i datës 28.06.2017.
7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:


1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
3. Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
4. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhehar Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Assambly

01.Nr.464-20356 /2017
Kaçanik, 27.06.2017

Në bazë të nenit 4 të ,paragrafi 2.4,3.6 ,pika 3.3.10 të Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtëshme Ligji 03/L-139 ,nenit 34.4 të Statutit të Komunës së Kaçanikut,Kryetari i Komunës

Propozon

Që Kuvendi i Komunës,në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2017 ,të merr këtë

VENDIM

PËR VËRTETIMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PËR NDËRTIMIN E REZERVARIT TË UJIT

I.

VËRTETOHET se ndërtimi i Rezervuarit të ujit në f.Soponicë është në interes të përgjithshëm publik dhe se lidhur me te mund të filloi procedura e shpronësimit.

Patundshmëria në të cilën duhet të ndërtohet Rezervuari i ujit përbëhet nga parcela kadastrale nr.00911-1 ,me kulturë mal i kl.3 ,me sipërfaqe prej 0.13.89 ha ,Z.K Soponicë ,në emër të Fari Nazmi Demnika nga f.Soponicë .

II.

Për zbatimin e këtij aktvendimi do të kujdesohet Drejtoria e Energjencave dhe Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Kryetari
Z.Besim Ilazi

Arsyetim

Drejtoria për Energjenca dhe Shërbime Publike duke u bazuar në Projektin për ndërtimin e Rezervuarit të ujit në f.Soponicë për nevojat e ujit të pijës për qytetarët e fshatrave Elezaj ,Doganaj ,Koxhaj dhe Kaçanik i Vjetër e që është me interes të veçant publik për banorët e këtij lokaliteti..

Kjo Drejtori duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke i marr parasysh Interesin Publik për ndërtimin e rezervuarit të ujit i cili ka karakter të interesit publik dhe pas miratimit të këtij Propozim Vendimi nga ana e Kuvendit të Komunës duhet të filloi edhe procedura e Shpronësimit për pasurinë e palujtëshme të theksuar më lartë.

Drejtori
Ramadush Osmani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR/ MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/ MINISTRY OF
ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY
Formulari nr. 5

Nr. i lëndës/protokolit:303/2017

Komuna: KAÇANIK

Zona Kadastrale;SOPONICË

Në mbështetje të Nenit 3 al. 3.6 dhe 3.7 të Ligjit mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme Ligji Nr. 2002/5 dhe 2003/13, në bazë të kërkesës e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike të datës 23.06.2017, Zyra Kadastrale, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET-kërkesa e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike të datës 23.06.2017, e cila ka të bëjë me elaborate i shpronsimit për ujin dhe ndarjën fizike për nevoja publike të ujsjellësit, të parcelave kadastrale të pasurisë së paluajtur, në bazë të regjistrit të fletë paraqitjeve **3/2017**, dhe ate:

Parcela Kadastrale nr.00911-0, me kul.mal e kl.3, me sip.prej 1.45.67 ha, e evidentuar në emër të z.Fari Nazmi Demnika nga fsh.Soponicë.

Kurse gjendja e re:

Parcela Kadastrale nr.00911-1, me kult.mal kl.3, me sip.prej 0.13.89 ha,

Parcela Kadastrale nr.00911-2, me kult.mal kl.3, me sip.prej 1.32.44 ha, e evidentuar në emër të z.Fari Nazmi Demnika nga fsh.Soponicë.

A r s y e t i m

Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike të datës 23.06.2017, ka parashtruar kërkesën pranë Zyres Kadastrale të Komunës **Kaçanik**, e cila ka të bëjë me elaboratin e shpronsimit për ujin dhe ndarjën fizike për nevoja publike të ujsjellësit, të parcelave kadastrale të pasurisë së paluajtur, në bazë të regjistrit të fletë paraqitjeve **3/2017** dhe kërkesës së tyre ia kan bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrim në Regjistrin e Paluajtshmërive (lloji i dokumentit):

Regjistri i fletëparaqitjeve **nr.3/2017**, të dates **27.06.2017**, letërnjoftimi fototkopje dhe pagesa e taksës. Sipas gjendjës së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrim sipas Ligjit mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligji Nr. 2002/5 dhe 2003/13 dhe nenit 12 e 13 (sipas detyrës zyrtare) të Udhëzimit Administrativ Nr. MPSH 2004/03 mbi Zbatimin e Ligjit mbi regjistrin.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e këtij Aktvendimi.

Aktvendimi i dorëzohet: Arkivit, shërbimit përkatës dhe parashtruesit të kërkesës.

Dat: 28.06.2017
Zyrtari I RDPP
Arlinda Zeqiri





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREZINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT: P-70917083-00911-1

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number:	303/2017
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	28.06.2017-14.17
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik/Kaçanik/Kaçanik
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:	SOPONICE/SOPOTNICA/SOPONICE
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	Kaçanik/Kaçanik/Kaçanik

Drejtori/Direktor/Director

Referenti/Referent/Referent

A. TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i lëndës Kadastrale / Broj katastarske jedinice / Cad. unit No. / KAK	Lloji i njësise / Vrsta jedinice / Unit Type	Lloji i pronës / Vrsta imovine / Property Type	Zona / U/R / U/R	Sipërfaqja / Përfaqja / Površina / Area / m2	Përshkrim / Opis / Description	Krijuar më datën / Uradeno na dan / Created on	Azhurnuar / Azurirano / Updated
P-70917083-00911-1	PARCELE PARCELA / PARCEL	Prone private Privatna / Imovina Privately owned Land	R	1389	3-2017	28.06.2017	28.06.2017

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur / Zvano mesto / Place name	Kodi postar / Poštanski fah / Postal Code	Hollësitë e adresës / Pojednostoi adrese / Address Details	Krijuar më datën / Uradeno na dan / Created on	Azhurnuar / Azurirano / Updated
LUBOVECA/LUBOVEC/LUBOVEC	-	//	28.06.2017	28.06.2017

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIÇENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriçenja parcele Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriçenje parcele Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kualiteta Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m2)
1	Pyjorë shumsko Forestry	Tokat Pyjorë shumsko zemljište/Forest	Mal I Klases 3 Suma 3 Klase/3rd Class Forest	1389

B. PRONARI/POSEDEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lidni broj ID. no.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi postar Poštanski bri Postal Code	Hollësitë e adresës Pojediniosti adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual/Individualna Drzavina single possessor	DEMIKA FARI (NAZMI)	1004589773	SOPONICE/SOPOTNICA / SOPOTI	-	//	1.1	541.2016	28.06.2017



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo


Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Štedine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastreale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office : KAÇANIK
Zona Kadastreale / Katastarska Zona / Cadastal Zone : Sopotnicë

Njësia / Jediniца / Unit	Tipi / Vrsta / Type	Sipërfaqja / Površina / Area m2
P-70917083-00911-1	Parcelë / Parcela / Parcel	1389,0
plot. 303/17		



Shkalla / Razmera / Scale: 1:786



Punio / Otvorio / Created:

Data / Datum / Date: 28.08.2017

Koha / Vreme / Time: 02:22:53

Nënshkrimi / Potpis / Signature:

Shënimi / Beležka / Note:

Aptoj / Usvojio / Approved: MCO KAÇANIK director

Nënshkrimi / Potpis / Signature:



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.404-20356/17, për shpalljen e interesit të përgjithëshëm publik për parcelën kadastrale: Nr.00911-1, në Soponicë, për ndertimin e rezervuarit të ujit të pijës për fshatrat Elezaj, Doganaj, Koxhaj dhe Kaçanik i Vjetër.
I miratuar më datë më datë: 30.06.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.